

Sefer Tahiri, PhD¹

UDC:

316.774-042.[323.12:28(497.7)]

**ROLI I MEDIAVE NË PËRHAPJEN E STEREOTIPEVE FETARE
DHE ISLAMOFOBISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

**УЛОГАТА НА МЕДИУМИТЕ ВО ШИРУВАЊЕТО НА
ВЕРСКИТЕ СТЕРЕОТИПИ И НА ИСЛАМОФОБИЈАТА ВО
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА**

**MEDIA'S ROLE IN SPREADING OF RELIGIOUS STEREOTYPES
AND ISLAMFOBBY IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA**

Abstract

This scientific paper, exam the spread of stereotypes on the basis of religious affiliation as a phenomenon influenced by many social factors, which undermines interfaith cohesion in a society such as Macedonia, which has heterogeneous religious structure.

Generally media as a very important social factor, but often rather than objectively reflecting certain groups, in some cases they do so by starting from the individual prejudices of journalists, chief editors, managers and mass media owners in Macedonia, as the traditional press, radio and television, or new online media.

Research shows that, when Islam is reported as a religion, generalization occurs, although this is not a unique phenomenon of media environment in Macedonia.

In certain media, mainly in the Macedonian language, there are Islamo- phobic tones, due to the lack of knowledge of the religious sphere, namely Islam, and their narrative that does not clearly distinguish religion from other destructive phenomena of the contemporary world such as: global terrorism, radicalism and violent extremism,

¹ ITSHKSH/ UEJL, sefer.tahiri@seeu.edu.mk

especially after the beginning of the new millennium, and the terrorist attacks in New York on September 11, 2001.

Although they are not so dominant, the same stereotypes are in contradiction with the basic professional standards and ethical norms laid down by the International Federation of Journalists, the Code of the Association of Journalists of Macedonia, the Macedonian legal and constitutional provisions, as well as many manuals on diversity reporting, which strictly prohibits religious discrimination and the language of grief on religious grounds.

Also, through concrete examples it is explained how the issue of refugees from Syria and the Middle East countries, in the country's media is defocused by a real problems that the people of this region of the world have from wars, on other issues related to the penetration of Islam in Europe and Macedonia.

In this paper is also analyzed the level of Islamophobia in Macedonia, presented in the public sphere in Macedonia and especially in the media, taking into the account the Report on the Islamophobia in Europe.

Key words: media, religious stereotypes, Islamophobia, prejudices, and media literacy.

Prezantimi dhe stereotipizimi në media

Jetojmë në kohën kur pjesën më të madhe të përditshmërisë e kalojmë duke ndjekur mediat e ndryshme (më shumë televizionin dhe median onlajn dhe shumë pak radion dhe gazetën). Qytetari bashkëkohor sot i ekspozohet shumë informacioneve, porosive dhe përmbajtjeve mediatike, të cilat ndikojnë ndaj vetëdijes së tij, ndërsa në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme formësojnë apo marrin pjesë në ndërtimin e identitetit tonë personal, por edhe identitetit të grupeve, të cilave u takojmë. Sjellja e të tjerëve ndaj neve kryesisht varet nga mënyra se si ata na perceptojnë realisht. Gjithashtu edhe e kundërta, sjelljet tona ndaj të tjerëve varen nga perceptimi që kemi për të tjerët, i cili burim kryesor ka prezantimin mediatik të ngjarjeve dhe dukurive shoqërore.

Në *Doracakun për arsimitarët e shkollave fillore dhe të mesme "Edukimi mediatik"* prezantimi në cilën do media përkufizohet si "*konstruktion i secilës media (dhe veçanërisht mediave masive) i aspekteve të "realitetit" siç janë njerëzit, vendet, objektet, ngjarjet, identitetet kulturore dhe konceptet tjera abstrakte*" (Çendler, 2008, i cituar në Troshanovski: 81). Kjo do të thotë se çdo informacion (përmbajtje) që mediat e plasojnë deri te publiku paraqet konstruktion.

Mediat përveç që bëjnë konstruksionin e realitetit përmes gjuhës mediatike, i cili njihet ndryshe edhe si realitet subjektiv mediatik, në prezantimin mediatik jo rrallë hasim stereotipizimin.

Stereotipat (dhe me këtë edhe procesi i stereotipizimit) janë një sërë besimesh pozitive ose negative, që një individ i ka në lidhje me karakteristikat e një grupi të njerëzve. Ato shpesh prezantohen si fenomen negativ, sepse paraqesin reduktim të spektrit të gjerë të karakteristikave që njerëzit/ grupi i posedojnë dhe deri te kategorizimet e thjeshta.

Stereotipat paraqesin supozime për disa grupe dhe të njëjtat i paraqesin si tregim real për grupet. Jo rrallëherë përdoren që ta arsyetojnë pozitën e atyre që kanë pozitën e “forcës”. Ndikojnë ndaj paragjykimeve sociale me qëllim që pabarazia të ekzistojë. (Troshanovski M. et al, 2010: 85)

Në këtë doracak që u dedikohet arsimitarëve të shkollave fillore dhe të mesme, grupet që janë objekt i stereotipizimit shpesh nuk konsultohen lidhur me mënyrat se si prezantohen. Linja midis efekteve pozitive dhe negative të stereotipave është shumë e hollë „sepse si informacione jo të plota, përgjithësisht (gjeneralizime) dhe të pjesshme, pavarësisht janë të vërteta apo jo ndikojnë ndaj perceptimit të disa personave apo grupeve, jo rrallë duke krijuar përshtypje të gabuar për të njëjtët dhe përhapin paragjykime” (Po aty, f 86)

Njëri nga funksionet e stereotipave është ruajtja e kufijve- të përkufizojë se “kush përket” dhe “kush është jashtë”. “Kufijtë midis grupeve sociale lehtë vërehen në realitet, stereotipizimi i mban, madje edhe i krijon dallimet në realitet, atje ku ka ngjashmëri”. (Dyer, 1993:16).

Analiza e përmbajtjeve mediatike tregon se stereotipat në media i hasim gjatë portretizimit të:

- pakicave kombëtare
- feve të ndryshme
- racave të ndryshme
- gjinive të ndryshme (grave dhe meshkujve)
- personave me aftësi të veçanta etj.

Korniza normative-juridike dhe vetërregulluese mbi raportimin rreth çështjeve ndëretnike dhe ndërftare

Raportimi mediatik mbi çështjet ndëretnike dhe ndërftare është pjesë e dokumenteve fundamentale ndërkombëtare, si edhe e dispozitave nga legjislacioni vendas, por është edhe pjesë e kodeve gazetareske dhe praktikave profesionale gazetareske:

- Dispozitat e nenit 10 të Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut, të implementuara në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe në Ligjin e mediave, që kanë të bëjnë me parimet mbi të cilat duhet të ndërtohen programet, me theks të veçantë mbi respektimin e të drejtave dhe lirive të individëve dhe grupeve dhe komuniteteve të ndryshme në shoqërinë maqedonase. (Direktiva për Shërbime Audiovizuale Mediatike të BE-së. Akces: http://www.avmu.mk/images/stories/doc/eu-docs/Direktiva_prevod.pdf , i parë 22.11.2017)

- Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë, gjegjësisht neni 10 sipas të cilit *“gazetari nuk do të krijojë apo riprodhojë me vetëdije informacione që cenojnë të drejtat apo liritë e njeriut, nuk do të përdorë gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim në asnjë bazë (nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientimi seksual, politik...)”*, si edhe neni 11 i cili thotë se *“gazetari do t’u përmbahet edhe standardeve të pranuar në përgjithësi të mirësjelljes dhe respektimit të diversitetit etnik, kulturor dhe religjioz në Maqedoni”*. (Kodi Etik i Gazetarëve në Republikën e Maqedonisë. Qasje: <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/440>, parë 22.11.2017)

- Kodi i parimeve të sjelljes së gazetarëve i Federatës Ndërkombëtare të gazetarëve (IFJ), ku, mes tjerash, theksohet se *“gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm mbi rrezikun nga nxitja e diskriminimit përmes mediave dhe duhet bërë përpjekje maksimale të evitojnë diskriminim në bazë të racës, gjinisë, orientimit seksual, gjuhës, religjionit, opinionit politik apo ndonjë opinionit tjetër, origjinës nacionale apo shoqërore”*. (Kodi i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve. Qasje: <http://www.ifj.org/default.asp?index=192&Language=EN>, parë 23.11.2017)

- Doracaku për raportim mbi diversitetin i publikuar për vendet e Ballkanit nga ana e Institutit për Diversitete në Media nga Londra (MDI), ku janë elaboruar udhëzime të hollësishme për gazetarët lidhur me standardet profesionale në raportimin mbi diversitetin. (Tuller, 2013).

- Udhëzimet redaktuese të Korporatës radiodifuzive Britanike (BiBiSi) dhe mediave tjera me renome ndërkombëtare, të cilat paraqesin kodeksin më detajor profesional të përpunuar për raportimin gazetaresk lidhur me tema të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe raportimin mbi diversitetin fetar; (The BBC’s Editorial Values <http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/>, parë 24.11.2017).

• Publikimi “Raportimi mbi diversitetet: standardet evropiane, kuadri vendor juridik dhe kodet etike” i përgatitur nga Shkolla e Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun, (<http://vs.edu.mk/vs.edu.mk/attachments/Mediumi-izbori-MK.pdf>, parë 24.11.2017.)

Prezantimi i Islamit në mediat në Maqedoni

Mediat kanë një rol mjaft të fuqishëm si një agjens për promovimin ose ndrydhjen e Islamofobisë. Pas 11 shtatorit të vitit 2001, kur ndodhën sulmet ndaj kullave binjake në Nju Jork bota më nuk është e njëjtë si më parë. Në kuadër të publikimit me titull “*Krizat e botës moderne- sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale kundrejt fundamentalizmit religjioz*” thuhet:

Mbulimi mediatik i çështjeve që lidhen me Islamin ka ndryshuar në mënyrë dramatike nga fillimi i mileniumit të ri, si në cilësi ashtu edhe në sasi. Nëse shihet linja kohore e njoftimeve, pastaj termat që i shfrytëzojnë reporterët dhe gazetarët, si dhe përmbajtja e publikimeve gjatë dy dekadave të kaluara shihet se në raportimet mediatike në raport me fundamentalizmin, Islamin radikal, sulmet terroriste ose veprimet antiterroriste, pavarësisht a janë me karakter global ose lokal mund të njihen dy valë (faza) të kumtimeve: vala- fenomenologji, ku mediat merren me çështje të motivuara kryesisht nga ndonjë ngjarje ose vala-ontologji ku më hollësisht shqyrtohen bazat e predikimit islam, të cilat mund të jenë kërcënim për sigurinë. (Dodovska, 2014: 82)

Termt kryesor që dominojnë në mediat e valës së parë janë Islami (myslimanizmi) Xhiahadi (lufta e shenjtë, lufta e drejtë e myslimanëve), Sheriati (e drejta islame), xhihadistët, muxhahedinët, talebanët, islamistët, ekstremistët islamikë etj.

Maqedonia edhe pse sipas përkufizimit kushtetues është shtet shekullar, në jetën shoqërore dhe politike të saj feja ka rol tepër të rëndësishëm. Shpesh vendi ndahet edhe mbi bazën e përkatësisë fetare për shkak të strukturës demografike që ka, duke pasur parasysh se nga të dhënat e fundit të regjistrimit të vitit 2002 vërtetohet se 64.7 % e popullsisë është e krishterë ortodokse, ndërsa 33.3 % e identifikojnë veten si myslimanë. Ndërsa dihet qartë se ndarja përgjatë linjave etnike dhe politike është po ashtu e theksuar, madje ndarja etnike është e nivelit më të lartë se sa ndasitë fetare. (Enti i Statistikës, <http://www.stat.gov.mk/publikacii/knigaX.pdf>, parë 24.11.2017).

Gazetarja *Katerina Neshkova* në analizën e saj me titull “*Trajtimi mediatik i islamit radikal si kërcënim për sigurinë*” në kuadër të publikimit me titull “*Krizat e botës moderne- sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale kundrejt fundamentalizmit religjioz*”, thekson se mediat maqedonase e trajtojnë çështjen e Islamit radikal si kanosje për sigurinë, mënyrë që nuk dallohet nga ajo se si e bëjnë një pjesë e mediave botërore ose ballkanike.

Varësisht nga pesha, zhvillimet botërore dhe ballkanike në këtë temë shpesh janë top- lajmet në televizionet, gazetatat dhe portalet informative të internetit maqedonas. Duke marrë parasysh aspektin ndërfaqësor (të krishterë dhe myslimanë) të marrëdhënieve ndëretnike (maqedonas-shqiptarë) në shtet si dhe faktin se kjo mund të ndikojë në stabilitetin e shtetit, në redaksitë maqedonase ka madje gazetarë special që punojnë në këto tema religjioze. Mundësia për Islamit radikal dhe sa ai ka depërtuar në Maqedoni trajtohet periodikisht, por pa ndërprerje nga viti 2001 e këndeje varësisht nga aktualiteti i çështjes dhe disponimi i informacioneve për këtë temë. (Dodovska, 2013: 94).

Në publikimin e Fondacionit Konrad Adenaur mbi sfidat kundrejt fundamentalizmit religjioz si shembull kemi disa tituj të mediave si vijon:

Nova Makedonija, 6 korrik 2010 , “*Një milion euro investime në islamin radikal*”, (<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=7610955528&id=9&setIzdanie=22026>) 159

Dnevnik, 1 Maj 2012, “*Islamistët radikal gjuajtën në Maqedoni*” (<http://www.dnevnik.mk/?ItemID=9B2074ECB33CA946BCD4629A25902542>) 160 1. MKD 2 maj 2012

MKD, 2 maj 2012, “*Maqedonia para kërcënimit serioz nga Islami radikal*” <http://www.mkd.mk/29095/makedonija/makedonija-radikalen-islam-ubistvo>

Nova Makedonija, 3 maj 2012, “*Gjashtë mijë terroristë islamik i bien kryq e tërthorë Ballkanit*” (<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=5312841126&id=9&prilog=0&setIzdanie=22570>)

Dnevnik, 16 gusht, “*Kryetari i BFI: Dy xhami në Shkup nuk janë nën kontrollin tonë të plotë*” (<http://dnevnik.mk/?ItemID=44A50D119A8C544CBDFD4B09CB2698AF>),

Kanal 5, 23 gusht 2014 “*BFI nuk kontrollon edhe disa xhami në rajonin e Prilepit-Krushevës*”. (http://kanal5.com.mk/vesti_detail.asp?ID=468)

Paragjykimet ndaj refugjatëve përfaqësojnë një formë të re të Islamofobisë në Maqedoni. Një artikull i titulluar “*Ahmedi nga Siria ka*

mbërritur në Serbi: Në vend të kishave, në Evropë do shihni minare. Ka për të qenë hakmarrje ndaj nesh”, u botua në gazetën e përditshme maqedonase Veçer, ndërsa mund të lexohet edhe në portalin e gazetës vecer.mk (Veçer, publikuar më 29.08. 2015, Qasje: <http://vecer.mk/balkan/ahmed-od-libija-stigna-do-srbija-namesto-crkvi-vo-evropa-kje-se-gledaat-minarinja-toa-kje>, e parë 27.11.2017). Në fakt bëhet fjalë për një raport nga Serbia që është plot me paragjykime, narrativ islamofob dhe shtrembërime të fakteve.

Shërbimi për verifikimin e fakteve (<http://verifikimiifakteve.mk>), projekt për fuqizimin e medias, raporton rastin e një artikulli që u publikua në një portal lajmesh, mkd-news.com, ku një video e marrë nga Youtube tregonte trazira në rrugët e Parisit; videoja ishte titulluar “*Migrantët po shkatërrojnë Parisin - ky është një nga incidentet më të rrezikshme (video)*” (Dukovska Jugoslava, publikuar më 09 12, 2015. <http://proverkanafakti.mk/recenzija-lazhni-obvinuvanja-i-promocija-naksenofobija/>, parë më 24 02, 2015). Megjithatë, videoja ishte marrë nga një burim gjerman dhe ishte shoqëruar me një tekst antiimigrant, anti-islam dhe ksenofobik. Në fakt, ngjarjet e shfaqura në video kanë ndodhur në korrik të vitit 2014 dhe media në këtë rast çorienton qëllimisht dhe raporton diçka krejtësisht tjetër për publikun, duke publikuar artikullin në gusht 2015 dhe duke e vendosur atë në kontekstin e krizës së refugjatëve nga shtetet e Lindjes.

Incidenti i Kumanovës në 9 maj të vitit 2015, në të cilin u vranë 10 pjesëtarë të grupit të armatosur dhe 8 policë, nga një pjesë e mediave dhe e rrjeteve sociale u përmend gjithashtu në lidhshmëri me Islamin. Shpesh është përmendur ideja se pjesëtarët e grupit kishin pasur lidhje me Sirinë dhe Irakun.

Në gusht 2015 ndodhi një operacion i madh antiterrorist në të cilin 9 persona u arrestuan nën dyshimin e pjesëmarrjes dhe rekrutimin për grupet e huaja paraushtarake. Media raportoi mbi etnicitetin e personave të arrestuar dhe përmendi një rast të një maqedonasi i cili ishte konvertuar në Islam. U ngrit debati në lidhje me motivimin për pjesëmarrje në ushtri të huaja – qoftë për bindje fetare apo për para.

Të gjithë këto shembuj vërtetojnë se një pjesë e mediave në gjuhën maqedonase gjithmonë kanë pasur qasje, e cila është e bazuar tek stereotipizimi negativ në dimensionin etnik ndaj shqiptarëve dhe në dimensionin fetar ndaj pjesëtarëve të fesë islame. Më pak për shkak të mosnjohjes së termave, më shumë për shkak të tendenciozitetit në raportim, gazetarët e mediave të ndryshme, pavarësisht se cilit publik i

drejtohen nuk bëjnë dallimin, edhe pse ai është i qartë dhe i dukshëm midis Islamit si fe, si religjion dhe tentimit të individëve apo grupeve e klaneve të caktuara për keqpërdorimin e religjionit islamik si ideologji politike, por edhe terroriste.

Gazetat e përditshme “Nova Makedonija” dhe “Veçer” në kohën e monizmit demonizonin shqiptarët dhe pjesëtarët e komunitetit mysliman, ndërsa Televizioni i atëhershëm i Shkupit në gjuhën maqedonase (sot Radiotelevizioni Maqedonas) prodhonte kronika televizive, në të cilat flitej me nënçmim ndaj xhamive si objekte islame. Edhe pas pavarësimit të Maqedonisë në vitin 1991 nuk është se ka pasur ndonjë qasje interkulturore ndaj raportimit të diversiteteve fetare, ndërsa përveç faljes së Bajramit dhe përcjelljes së porosisë nga kreu i Bashkësisë Fetare Islame mbi këtë festë, nuk ka pasur ndonjë program edukativ ose dokumentar mbi njohjen e religjionit islam.

Raportimi stereotipizues ndaj Islamit do të bëhet edhe më i theksuar sidomos pas ngjarjes tragjike, vrasjes së pesëfishtë te liqeni i Smillkovcës, që ndodhi më 13 prill të vitit 2012 tekstet dhe artikujt gazetaresk i prodhojnë, riprodhojnë ose sforcojnë diskurset që çojnë drejt efektit stereotipizues, ksenofobik apo diskriminator ndaj ‘tjetrit’ kolektiv në vend.

Analiza më e thuktë dhe më përmbajtësore është ajo cilësore e raportimit mediatic mbi çështjet ndëretnike dhe ndërftare në Republikën e Maqedonisë- standardet profesionale në raportimin mbi vrasjen në Smillkovcë. Trajtohen standardet profesionale përmes prizmit të analizës diskursive dhe trajton narrativët mediatic në raportimin mbi vrasjen. (Shopar, 2014, *Raportimi për tensionet ndëretnike dhe ndërreligjioze- rëndësia pas titujve*, <http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Znacenjeto-zad-naslovite.pdf>, parë 23.11.2017)

Analiza e përgatitur nga Shkolla e Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun në bashkëpunim me Katedrën e UNESCO-s për Media, Dialog dhe Mirëkuptim të Ndërsjellë përveç ditës së vrasjes analizon edhe:

(1)16 prillin – protestat të cilat ishin shprehje e revoltës kundër vrasjeve;

(2)1 majin – akti i arrestimit të të dyshuarve për vrasjen në Smillkovcë;

(3)4 majin– protestat kundër mënyrës së mbarëvajtjes së procesit kundër të të dyshuarve.

Analiza vjen në përfundim se një problem tjetër serioz në raportimin në këtë pikë kohore ishte inkuadrimi i stërtheksuar i kësaj ngjarjeje në narrativin e “Islamit radikal”, që ishte deklarata e pamatur e ish-ministres së Brendshme, Gordana Jankullovaska dhe “kërcënimit të sigurisë për Maqedoninë” nga siç u quajt “fundamentalizmi islamik dhe nga terrorizmi global. Me një inkuadrim të tillë, Islami si fe apriori lidhet me strukturat radikale dhe me terrorizmin global”.

Disa gazeta të caktuara në mënyrë selektive theksuan deklarata ose informacione të caktuara, si dhe transmetuan informacione nga mediat e huaja, në mënyrë që t'i prezantojnë protestat si pjesë e një lëvizjeje të strukturave radikale islamike që kërcënojnë shtetin ose që paraqesin problem më të gjerë të sigurisë që rrjedh nga tensionet e mëparshme ndëretnike në shoqëri. Gazetarët duhet të shmangin supozimet rreth përhapjes potenciale të dhunës dhe kimit apo t'i inkuadrojnë ngjarjet në pikturën e veprimit global të lëvizjeve dhe strukturave radikale. (Shopar, 2013:137)

Janë vërejtur edhe fenomene në raportim me rastin e inkuadrimit të vrasjes: viktimizim dhe viktimizim reversiv. Në rastin e parë, mediat në gjuhën maqedonase këmbëngulin në përkatësinë etnike të viktimave dhe implikojnë se vrasësi është *tjetri etnik*, ndërsa në rastin e dytë, disa media në gjuhën shqipe vënë fokusin dominues mbi *shqiptarët si një viktimë e stigmatizimit me rastin e vrasjes*. Në raportimin e tyre, gazetarët duhet t'u shmangen dallimeve të mprehta midis “ne” dhe “ata” dhe të shmangin portretizimin e ngjarjes si një përplasje ndërmjet palës “tonë” dhe “tuaj”.

Një sondazh mbi fenë dhe gjuhën e urrejtjes fetare në Maqedoni u realizua nga Agjencia Rejing për nevojat e Institutit Maqedonas të Mediave, që u realizua në datat 14 dhe 15 tetor të vitit 2014 dhe tregoi se anëtarët e komunitetit mysliman në pjesën më të madhe vetëidentifikohen si viktima të gjuhës së urrejtjes. Ndonëse shumica e të anketuarve në sondazh deklaruan se “*nuk e miratojnë përdorimin e deklaratave publike, që përfshijnë urrejtje apo agresion karshi anëtarëve të grupeve të ndryshme fetare*”, se në opinionin e tyre gjuha e urrejtjes ekziston në hapësirën publike dhe në një masë të madhe në televizion (76.1%), në kontaktet personale (61.5%), në uebsite dhe rrjete të ndryshme sociale (53% dhe 51.7%), në grafite (shkrime murale) (47.8%), dhe në gazeta e revista (47.4%). 26.9% e të anketuarve përmendën gjuhën e urrejtjes në vende publike (shkolla, koncerte, ndeshje futbollit, etj...) dhe 10% e të anketuarve përmendën gjuhën e urrejtjes në radio. (Agjencia Rejting, Rating Agency, 2015, <http://bezomrazno.mk/wp->

content/uploads/2013/10/Narativen-opis-religija-i-prisutnosta-nagovor-na-omraza-vo-RM.pdf, parë 26. 11.2017).

Islamofobia në Maqedoni sipas Raportit të Islamofobisë Evropiane - 2015

Siç u tha edhe më lartë kriza e refugjatëve në vitin 2015 tregoi se islamofobia në kontekstin e Maqedonisë nuk është e lidhur ekskluzivisht me përkatësinë etnike, por gjithashtu edhe me ksenofobinë.

Raporti European i Islamofobisë (EIR, European Islamophobia Report) është një raport i përvitshëm.

Incidentet dhe zhvillimet që janë relevante për ekzistencën e islamofobisë në Maqedoni në vitin 2015 mund të lidhen me disa ngjarje të ndryshme në rrafsh global. Ngjarjet globale kanë pasur një impakt më të madh mbi diskursin dhe zgjatimin e islamofobisë në Maqedoni; këto përfshijnë sulmet e Charlie Hebdo, që ndodhën më 7 janar të viti 2015, praninë e luftëtarëve në luftërat e huaja dhe debatin rreth tyre, krizën e refugjatëve (e cila ka prekur Maqedoninë, si pjesë e Itinerarit të Ballkanit, në një mënyrë mjaft të veçantë, me një numër të madh refugjatësh që kalojnë nëpërmjet këtij vendi, duke pasur destinacion BE-në) dhe sulmet e Parisit në nëntor të vitit 2015. (Bayrakli dhe Hafez, 2015: 358)

Islamofobia është e pranishme në të gjitha segmentet e shoqërisë. Monitorimi i Islamofobisë në fushën e politikës, medias dhe rrjeteve sociale sjell në sipërfaqe deklarata të hapura islamofobike, deklarata këto që duhet të dënohen. Rekomandimi në lidhje me ngjarjet diskursive që përmbajnë elementë islamofobikë përfshin njohjen, dekonstrukcionin dhe debatin e moderuar publik mbi këto çështje.

Sulmet terroriste në Paris, që ndodhën më 13 nëntor të vitit 2015, i dhanë hov islamofobisë në Maqedoni, më së shumti në rrjetet sociale, por gjithashtu edhe në media. Krahas kësaj, ndjesitë islamofobe u shprehën edhe më tutje, kryesisht ndaj refugjatëve që po kalonin nëpër Maqedoni dhe në debatin e ngritur mbi çështja e luftëtarëve nga Maqedonia në luftën e Sirisë.

Conclusions

If both traditional and contemporary mass media are analyzed from the perspective of the media language that the radio and TV programs present, their online and press contents, we can see that certain social groups create stereotypes on them. The media in Macedonia are

not only using stereotypes based on ethnic, racial, gender or on people with limited abilities background, which in most cases are not intentional but there are cases when such stereotypes have ideological and political tendency.

Even though all international human rights and freedoms conventions and the International Journalists Federation Code as well as the Code of Association the Journalists of Macedonia strictly prohibit the use of a discriminatory language on religious basis, one part of the media that produce program in Macedonian language often violate professional standards, which foresee the fading of religious stereotypes. This is because in many media, the majority of journalists that deal and analyze religious issues lack the basic knowledge on religion and comparative theology, which is the basic rule of reporting on religious diversity.

The media reports about Islam and issues related to this religion contain stereotypes, especially after the terrorist attacks in New York on September 11th of 2001, Media puts Islam as a monotheist religion with its particularities and qualities that differ from other religions in the same basket with religious fundamentalism, terrorism and radicalism.

There is one more conclusion that the intensity of media to create stereotypes and use language of prejudices in Macedonia is growing, especially after the fivefold assassination at the lake of Smilkovc. This was due to the fact that the political accusation against the suspects and then the convicts of this case was against the rules of intercultural communication, as the former Interior Minister of Macedonia improperly accused the suspect of being related to what she termed as "radical Islam".

The wave of refugees from the East in certain media has added even more religious stereotypes and the stigmatization of Islam and its members who have had refugee status, a way of reporting, which increases the index of Islamophobia in Macedonia.

Therefore, to avoid stereotypes and Islamophobia in local, regional and national media in Macedonia, journalists and all those with editorial responsibilities need to respect professional and ethical journalistic codes, recognize the principles and rules of diversity reporting, while training and organizing many discussion panels on this topic. As far as the public is concerned, it is recommended that citizens from elementary education follow the basic principles of media education,

not as new scientific discipline, but within other subjects. Thus, we will have intercultural communication and interaction as a precondition for tolerance, understanding, interethnic and inter-religious integration and social cohesion in Macedonia. This is very important for Macedonia, its stability and Euro-Atlantic perspective.

Literatura e shfrytëzuar

Dyer, R. (1993) *The Matter of Images: Essays on Representation*. New York, London: Routledge

Dodovska, I. (Ed.). (2014). *Krizat e botës moderne-sfidat rajonale dhe globale të demokracisë liberale kundrejt fundamentalizmit religjioz*, Shkup: Fondacioni Konrad Adenauer, përfaqësia në Republikën e Maqedonisë Instituti ResPublika, akses: http://www.kas.de/wf/doc/kas_14936-1442-2-30.pdf?150126152900

Troshanovski, M., Nikodinovska V., Saraçini P., Tuneva M., Gjorgjinska J., Temenugova A., Andonov D., Misev V., Xhigall S., Bulldiovski D., (2010) *Doracak për arsimitarët për mësimin e edukimit mediatik në mësimin e gjuhës amtare*, Shkup: Instituti Maqedonas i Medias dhe Instituti për Demokracia “Societas Civilis”

Tuneva, M. (Ed) (2013) *Raportimi për dallimet: standardet evropiane, kuadri vendor juridik dhe kodet etike*, akses <http://vs.edu.mk/vs.edu.mk/attachments/Mediumi-izbori-MK.pdf>

Tuller, D. (2003) *Doracak për raportim për diversitetin*, Londër: Instituti për Diversitete në Media,

Shopar, V. (Ed.). (2013). *Raportimi për tensionet ndërreligjioze dhe ndërretnike: Rëndësia pas titujve*, Shkup, Shkolla e Lartë për Gazetari dhe Instituti i Studimeve të Komunikimit, Qasje: <http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Znacenjeto-zad-naslovite.pdf>

Burimet

Agjencia Rejting (2014), *Hulumtimi i religjionit dhe prania e gjuhës së urrejtjes në atë fushë në Republikën e Maqedonisë*, Qasje: <http://bezomrazno.mk/wp-content/uploads/2013/10/Narativen-opis-religija-i-prisutnosta-na-govor-na-omraza-vo-RM.pdf>, parë 20.11.2017

Bayrakli E. dhe Hafez F.(Ed.). (2015), *Raporti European i Islamofobisë*. Qasje: http://www.islamophobiaeurope.com/reports/2015/en/EIR_2015_MACEDONIA.pdf, parë 24.11.2017

Dukovska J. 09 12, 2015. Qasje s: <http://proverkanafakti.mk/recenzija-lazhni-obvinuvanja-i-promocija-na-ksenofobija/>, parë 24.11.2017

Enti i Statistikës, Qasje: <http://www.stat.gov.mk/publikacii/knigaX.pdf>, parë 24. 11.2017

Veçer, 29.08. 2015. Qasje: <http://vecer.mk/balkan/ahmed-od-libija-stigna-do-srbija-namesto-crkvi-vo-evropa-kje-se-gledaat-minarinja-toa-kje>, parë 27.11.2017

Ligjet, kodet dhe udhëzimet për gazetarët

Direktiva për Shërbime Audiovizuale Mediatike të BE-së. Qasje: http://www.avmu.mk/images/stories/doc/eu-docs/Direktiva_prevod.pdf

Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/2013),

Ligji për Mediat (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/2013)

Kodi Etik i Gazetarëve në Republikën e Maqedonisë. Qasje: <http://znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/440>

Këshilli i Etikës i Mediave në Maqedoni. Qasje: <http://semm.mk>

Kodi i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve. Qasje: <http://www.ifj.org/default.asp?index=192&Language=EN>

Al Jazeera Code of Ethics http://www.aljazeera.com/aboutus/2006/11/20085_25185733692771.html

AP NEWS VALUES & PRINCIPLES

<http://www.ap.org/company/News-Values>

The BBC’s Editorial Values <http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/>

Guardian News & Media Editorial Code <http://www.mediawise.org.uk/wp-content/uploads/2011/08/>

Guardian News & Media Editorial Code <http://www.mediawise.org.uk/wp-content/uploads/2011/08/GuardianEditorialGuidelinesAug2011.pdf>

Independent Press Standards Organizations https://www.ipso.co.uk/assets/82/Editors_Code_of_Practice_A4_March_2015.pdf

The New York Times – Ethical Journalism http://www.nytimes.com/wp-content/uploads/NYT_Ethical_Journalism_0904-1.pdf

(Punimi shkencor u prezantua në Konferencën e parë Ballkanike me temë “Pozita, roli dhe perspektiva e gruas në Ballkan”, e organizuar nga Asociacioni për Afirmimin e Gruas më 14 dhe 15 tetor të vitit 2016 në Shkup)